TRE DËMQARËT MË TË MËDHENJ TË POPULLIT DHE KOMBIT SHQIPTAR

BENITO MUSSOLINI – DUÇJA, i cili e pushtoi Shqipërinë dhe e shkatërroi shtetin e pavarur dhe të konsoliduar shqiptar, duke i paraprirë ardhjes së komunizmit.

Njerëz, mos mendoni se Meloni ëndërron më pak se idhulli i saj kur sheh se çfarë po bën dhe me kë po e bën cenimin e integritetit territorial të Shqipërisë në Gjadër!

ENVER HOXHA, i cili e shiti Kosovën te Josif Broz Tito, me Miladinin dhe Vukun, e shkatërroi popullin shqiptar ekonomikisht, e shkatërroi klasën e mesme dhe intelektualët, e izoloi, e persekutoi, e ekzekutoi dhe e poshtëroi në mënyrën më të paimagjinueshme. Kur vdiq, ai e kishte lënë popullin shqiptar më të varfërin në botë.

EDVIN KRISTAQ RAMA, i cili shkatërroi tërësisht demokracinë e brishtë shqiptare, luftoi kundër pavarësisë së Kosovës dhe shpiku ndarjen e saj përmes Ballkanit të Hapur në favor të Vuçiçit; I vjedh zgjedhjet dhe, bashkë me to, edhe tërë buxhetin e shtetit shqiptar, i mbështetur nga grupi i tij kriminal i ashtuquajtur “Rilindje”; E degjeneroi moralisht shoqërinë shqiptare, ndryshoi përkufizimin e burrit dhe gruas, mashkullit dhe femrës dhe e çpopulloi Shqipërinë deri në përmasa tragjike të pariparueshme. Këtë gjë nuk kishte arritur ta bënte as turku, as serbi, as greku, as fashizmi, as komunizmi, brenda një dekade sundimi absolut.